



Skenderbeu ka ndjekur hapin e Teutes duke marre tre piket qe e mbajne ne krye te klasifimit. Dy golat e pjeses se pare nga Renato Arapi dhe Amarildo Dimo jane vene ne rrezik nga goli i kroatit Buljan ne fillimin e pjeses se dyte. Kampionet kane rrezikuar te barazohen sidomos ne 15 minutat e fundit te lojes kur kane ngelur me nje lojtar me pak. Sabien Lilaj ka dale me karton te kuq dhe Josa eshte detyruar te rreshtojte pothuajse te gjithë ekipin ne mbrojtje per te mos u barazuar perballe Lacit. Korcaret kane festuar ne shtepi me fitoren e marre dhe keshtu nuk e kane leshuar kreun e tabelës ku premtojne te qendrojne deri ne fund.